

Raporti i Audituesit të pavarur dhe Pasqyrat Financiare të

**KARAVASTA SOLAR sh.p.k.**

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

**Përmbajtja:**

Raporti i Audituesit te Pavarur .....	i-iii
Pasqyra e Pozicionit Financiar .....	1
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse .....	2
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare .....	3
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital.....	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare.....	5-26

# Raporti i Audituesit të Pavarur

## **Për Drejtimin e Shoqërisë Karavasta Solar sh.p.k**

### *Opinion*

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Karavasta Solar shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2023 si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

### *Baza e Opinionit*

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Agjencia në përputhje me Kodin e Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës ("BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit

### *Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënime shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin e vijimësisë si bazë kontabile, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

### *Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe skepticismin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë, se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmeri të atyre kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga Drejtimi.

- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidences së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që është identifikur gjatë auditimit tonë.

**Grant Thornton sh.p.k.**

Tiranë, Shqipëri

25 qershor 2024

*Grant Thornton shpk*



*Auditues Ligjor*

*Erjona Isufi*

**KARAVASTA SOLAR SHPK**

Pasqyra e Pozicionit Financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

	Shënimi	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
<b>Aktive</b>			
Aktive afatgjata në proces	7	10,723,696,553	1,345,764,695
Aktivitet afatgjata jomateriale	8	25,012,461	28,877,057
E drejtë e përdorimit të asetit	9	-	1,741,088
Instrument financiar derivativ - aset	10	399,036,425	237,193,455
<b>Aktive afatgjata</b>		<b>11,147,745,439</b>	<b>1,613,576,295</b>
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	11	2,010,150,024	916,890,925
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	12	152,002,969	57,184,918
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>		<b>2,162,152,993</b>	<b>974,075,843</b>
<b>Totali i aktiveve</b>		<b>13,309,898,432</b>	<b>2,587,652,138</b>
<b>Kapitali neto</b>			
Kapital themeltar	17	867,386,000	12,386,000
Fitimi/humbja e pashpërndarë		(4,465,735)	(1,630,642)
Fitimi/(humbja) e vitit		408,361,029	(2,835,093)
Rezerva nga rivlerësim- VDATGJ	18	(190,020,670)	17,158,255
Diferenca nga rivlerësimi kursi kembimit		(16,369,709)	-
<b>Totali i kapitalit neto</b>		<b>1,064,890,916</b>	<b>25,078,520</b>
<b>Detyrimet</b>			
Hua të pagueshme	13	3,953,340,855	439,785,500
Interesa të pagueshëm	13	181,884,327	6,488,781
Instrument financiare derivative - detyrim	16	465,292,232	-
Detyrim qira financiare- afatgjatë	14	-	732,172
<b>Detyrimet afatgjata</b>		<b>4,600,517,414</b>	<b>447,006,453</b>
Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera	15	7,621,665,749	2,114,536,472
Detyrim qira financiare afatshkurtër	14	-	1,030,693
Tatim fitimi i pagueshëm	23	22,824,353	
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		<b>7,644,490,102</b>	<b>2,115,567,165</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>12,245,007,516</b>	<b>2,562,573,618</b>
<b>Total i detyrimeve dhe kapitalit neto</b>		<b>13,309,898,432</b>	<b>2,587,652,138</b>

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 26 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**KARAVASTA SOLAR SHPK**

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të tjera Gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Shënimi	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
<b>Të ardhura</b>			
Të ardhura nga shitja energjisë	19	2,970,990	-
Të ardhura të tjera	19	446,479,499	-
<b>Total Të ardhura</b>		<b>449,450,489</b>	<b>-</b>
<b>Shpenzime të veprimtarisë</b>			
Shpenzime personeli	20	(257,796)	(215,389)
Amortizimi/zhvlerësimi	8	(1,372,500)	(1,341,200)
Shpenzime operative	21	(28,672,856)	(1,227,568)
<b>Fitimi / (humbja) operative</b>		<b>(30,303,152)</b>	<b>(2,784,157)</b>
Fitim/(humbja) neto nga kursi i këmbimit		53,862,511	(50,925)
Shpenzime/(të ardhura) financiare të tjera, neto		8,175,534	(11)
<b>Të ardhura financiare, neto</b>	22	<b>62,038,045</b>	<b>(50,936)</b>
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>481,185,382</b>	<b>(2,835,093)</b>
Tatimi mbi fitimin	23	(72,824,353)	-
<b>Fitimi / (humbja) neto i vitit</b>		<b>408,361,029</b>	<b>(2,835,093)</b>
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse, pas tatimit	18	(207,178,924)	17,158,255
<b>Totali i të ardhurave / (humbjes) gjithpërfshirëse të vitit</b>		<b>201,182,105</b>	<b>14,323,162</b>

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 26 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**KARAVASTA SOLAR SHPK**

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

Shënimi	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2022
<b>I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>		
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>481,185,382</b>	<b>(2,835,093)</b>
<i>Rregullime për:</i>		
Amortizimin	1,372,500	1,341,200
Amortizim e drejtë përdorimi	783,488	348,218
Shpenzime për interesa	175,395,546	11
Lëvizjet në FA që mbahen me VDATGJ	(207,178,924)	17,158,255
Humbja/(fitim) neto nga nxjerrja jashte perdorimit	905,003	-
<b>Fitimi/ (humbja) operative nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>	<b>452,462,995</b>	<b>16,012,591</b>
<i>Ndryshime në kapitalin punues:</i>		
Pakësim/(ritje) në kërkesa për t'u arkëtuar	(1,093,259,100)	(916,008,110)
Rritje/(Pakesim) në detyrime për t'u paguar	5,507,129,277	2,114,519,731
<b>Mjetet monetare të përfituara nga aktivitetet</b>	<b>4,866,333,172</b>	<b>1,214,524,213</b>
Tatim mbi fitimin i paguar	(50,000,000)	-
<b>Mjetet monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>	<b>4,816,333,172</b>	<b>1,214,524,213</b>
<b>II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Blerja e aktiveve afatgjata jomateriale	-	(17,026,125)
Blerja e aktiveve afatgjata materiale në proces	(9,377,931,858)	(1,345,764,695)
Blerja e aktiveve afatgjata me te drejte perdorimi	-	(2,089,306)
Investime në instrumenta financiar	(161,842,971)	(237,193,455)
Levizje ne vlerën e instrumentave financiare - detyrime (derivativë)	465,292,232	-
<b>Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese</b>	<b>(9,074,482,597)</b>	<b>(1,602,073,581)</b>
<b>III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Kapitali themeltar	855,000,000	-
Huamarrje	3,513,555,354	442,547,861
Pagesa të qirasë financiare	(1,762,864)	1,762,864
<b>Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetet financuese</b>	<b>4,366,792,490</b>	<b>444,310,725</b>
<b>RRITJA (RËNIA) NETO E MJETEVE MONETARE</b>	<b>108,643,065</b>	<b>56,761,356</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël	57,184,918	423,562
Efektet e ndryshimit të kursit të këmbimit në balancen e mjeteve monetare në valutë të huaj	(13,825,014)	-
<b>MJETET MONETARE NË FUND TË PERIUdhës KONTABEL</b>	<b>152,002,969</b>	<b>57,184,918</b>

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 26 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**KARAVASTA SOLAR SHPK**

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

	Kapitali themeltar	Fitim / (Humbja) e pashpërndarë	Reserva nga rivlerësimi-vlera e drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse	Rezerva rivlerësimi nga kursi këmbimit	Total
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>12,386,000</b>	<b>(1,630,643)</b>	-	-	<b>10,755,357</b>
Humbja e vitit	-	(2,835,093)	-	-	(2,835,093)
Ndryshimi në vlerën e drejtë instrumentit financiar	-	-	17,158,256	-	17,158,256
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	<b>12,386,000</b>	<b>(4,465,736)</b>	<b>17,158,256</b>	-	<b>25,078,520</b>
Rritje kapitalit	855,000,000	-	-	-	855,000,000
Fitimi vitit	-	408,361,029	-	-	408,361,029
Ndryshimi në vlerën e drejtë instrumentit financiar	-	-	(207,178,924)	-	(207,178,924)
Lëvizje në rezervën e rivlerësimit	-	-	-	(16,369,709)	(16,369,709)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>867,386,000</b>	<b>403,895,293</b>	<b>(190,020,668)</b>	<b>(16,369,709)</b>	<b>1,064,890,916</b>

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 26 që janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Administratori i Karavasta Solar sh.p.k. më 6 pershor 2024.

  
**Sylvine Madeleine Muguette Morin ep Bouan**  
 Administrator

  
**Harues**  
 PwC Consulting Shpk



## **KARAVASTA SOLAR SHPK**

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

---

### **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

Karavasta Solar (më poshtë referuar si 'Shoqëria') është themeluar më 14 gusht 2020, me NIPT M02020001J. Shoqëria ka ortak të vetëm, shoqërinë VMI-ALB-Karavasta BV.

Shoqëria ka pjesë të aktivitetit të saj projektimin, ndërtimin, instalimin, komisionimin, financimin, operimin, përmirësimin, dhe mirëmbajtjen e centralit të prodhimit të energjisë nga dielli dhe infrastrukturës shërbyese, përfshirë panelet fotovoltaike të ndodhura në Remas - Karavasta, Lushnje, dhe Libofshë, Fier, Shqipëri sipas Kontratës për Zhvillimin e Projektit datë 31.07.2020 lidhur mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Voltalia SA.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është, Rr. Bajram Curri, Ndërtesa European Trade Center, Kati 9, Tiranë.

Administratorët e shoqërisë janë Bertrand Pierre Francis Tournier dhe Gustavo Manuel Ferreira Fernandes.

Shoqëria ka patur 2 punonjës (administratorë) më 31 dhjetor 2023.

### **2. BAZA E KONTABILITETIT**

#### **a) Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

#### **2.1 Parimi i vijimësisë**

Shoqëria nuk ka patur devijime nga shifrat e buxhetuara, drejtimi i Shoqërisë beson në vijimësinë e rezultateve pozitive dhe pa ndikim në aktivitetin e saj në të ardhmen. Drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhë dyshime mbi aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Për më tepër, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria siguron përmbushjen e detyrimeve të saj sipas kushteve të rëna dakord për dymbëdhjetë muajt e ardhshëm.

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL**

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në këto pasqyra financiare.

#### **3.1. Baza e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

#### **3.2. Monedha funksionale dhe raportuese**

Monedha funksionale e Shoqërisë është Euro. Përcaktimi se cilat janë kushtet specifike themelore ekonomike që përcaktojnë monedhën funksionale kërkon gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, Shoqëria vlerëson midis faktorëve të tjerë, burimet e të ardhurave si dhe rreziqet që lidhen me aktivitetet. Shumica e operacioneve të Shoqërisë janë të matura në Euro dhe gjithashtu, Euro është monedha në të cilën menaxhohen rreziqet dhe ekspozimet e Shoqërisë si dhe matet performanca e biznesit të saj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksioneve ose datën e vlerësimit në rastin e rimarrjes së zërave. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë përkthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Zërat jo monetare të cilat janë matur me kosto historike në monedhë të huaj, përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga konvertimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare të shprehura në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit njihen në fitime ose humbje. Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit paraqiten në pasqyrën e fitimit ose humbjes si "Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit, neto".

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)

#### 3.2. Monedha funksionale dhe raportuese (vazhdim)

Në këto pasqyra financiare, rezultatet dhe pozicioni financiar i Shoqërisë përkthehen në monedhën e paraqitjes si më poshtë:

- i) Aktivet dhe detyrimet për pasqyrën e pozicionit financiar përkthehen me kursin e mbylljes në fund të periudhës përkatëse të raportimit;
- ii) Të ardhurat dhe shpenzimet përkthehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Për ato raste kur kursi i datës së transaksionit nuk mund të përcaktohet, përdoret kursi mesatar;
- iii) Të gjitha diferencat që rezultojnë nga këmbimi njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

#### 3.3. Aktivet afatgjata materiale

##### i. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë vlerësuar me kosto historike dhe pakësuar për amortizimin e akumuluar apo zhvlerësimin.

Kostoja përfshin të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin kostot e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër të atribueshme për sjelljen e aktivitetit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato pasqyrohen si pjesë të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

##### ii. Kostot e zëvendësimit

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën neto të zërit nëse është e mundur që kosto e pjesës dhe përfitimet e ardhshme ekonomike nga pjesa zëvendësuese mund të maten me besueshmëri. Kostot e riparimit dhe mirëmbajtjes njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivi rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese. Fitimi ose humbja nga shitja apo nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen si diferenca mes shumës neto nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktivitetit (nëse ka) dhe vlerës kontabël (neto) të zërit.

##### iii. Amortizimi

Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën e vlerës kontabël neto, duke filluar nga data e vënies në përdorim e aktivitetit (nëse vënia në përdorim nuk është e menjëhershme). Toka nuk amortizohet. Normat e amortizimit dhe metodat e përdorura për kategoritë e aktiveve afatgjata materiale, si makineri e pajisje, automjete etj., paraqiten si më poshtë:

Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Kompjuter dhe pajisje informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mobilje zyre	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Përmirësime të pronës me qera	Mbi vlerën kontabël neto	5%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur për çdo kategori rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese.

#### 3.4. Qiratë

##### E drejta e përdorimit të aktivitetit

Shoqëria ka marrë me qira ambjente për zyra që përdoren për qëllimet e aktivitetit të saj ekonomik. E drejta e përdorimit të aktiveve maten me kosto, minus çdo zhvlerësim të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi dhe rregullohen për çdo ri-matje të pasiveve të qirasë.

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)

#### 3.4. Qiratë (vazhdim)

Kostoja e të drejtës së përdorimit të aktivitetit përfshin

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë;
- çdo pagesë qiraje e bërë në ose para datës së fillimit minus çdo stimul i marrë nga qiraja;
- çdo kosto fillestare direkte, dhe
- kostot për të rikthyer aktivin në kushtet e kërkuara nga marrëveshjet e qirasë.

#### Amortizimi

E drejta e përdorimit të aktivitetit përgjithësisht zhvlerësohet për periudhën më të hershme ndërmjet jetës së dobishme të aktivitetit dhe afatit të qirasë mbi një bazë lineare. Nëse Shoqëria ka baza të sigurta për të ushtruar një opsion blerjeje, aktivi i së drejtës së përdorimit zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të aktiveve. Amortizimi i zërave të aktiveve të së drejtës së përdorimit në lidhje me zyrat është 4 vite dhe llogaritet duke përdorur metodën lineare sipas kushteve të kontratës së qirasë.

#### Detyrimi i qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që duhen bërë gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë:

- pagesa fikse (përfshirë pagesat fikse në substancë), minus çdo stimul i qirasë së arkëtueshme,
- pagesa e ndryshueshme e qirasë që bazohet në një indeks ose një normë, e matur fillimisht duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit,
- shumat që pritet të paguhet nga Shoqëria nën garancitë e vlerës së mbetur,
- çmimi i ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse Shoqëria në mënyrë të arsyeshme është e sigurt për të ushtruar atë mundësi., dhe
- pagesa të penaliteteve për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron Shoqërinë që ushtron atë opsion.

Pagesat e qirasë zbriten duke përdorur normën e interesit të nënkuptuar në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, përdoret norma rritëse e huamarrjes së Shoqërinë, duke qenë norma që Shoqëria do të duhet të paguajë për të marrë hua fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të ngjashme, në një mjedis ekonomik me terma, kolateral dhe kushte të ngjashme. Për të përcaktuar normën rritëse të huamarrjes, Shoqëria zbaton normën e publikuar nga Banka e Shqipërisë për huazimet në euro për pasuri të paluajtshme dhe blerjen e pajisjeve, me një maturim prej 3 deri në 5 vjet. Pagesat e qirasë gjatë gjithë periudhës 5-vjeçare të kontratës për ndërtesën janë të ndryshueshme dhe ndryshojnë në bazë të çmimit për metër katror të sipërfaqes siç është rënë dakord nga palët, duke marrë parasysh çmimet e referencës për qira të ndërtesave për qëllime tatimore, sipas legjislacionit përkatës.

Pas datës së fillimit, shumat e detyrimeve të qirasë rritet për të reflektuar akumulimin e interesit dhe zvogëlohet për pagesat e kryera të qirasë.

Për më tepër, vlera kontabël e detyrimeve të qirasë ri-matet nëse ka një modifikim, një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë (p.sh., ndryshimet në pagesat e ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë të përdorur për të përcaktuar të tilla pagesa të qirasë) ose një ndryshim në vlerësimin e një opsioni për të blerë aktivin themelor.

Pagesat e qirasë alokohen midis kostos kryesore dhe asaj financiare. Kostot e financimit ngarkohen në fitim ose humbje gjatë periudhës së qirasë në mënyrë që të prodhojnë një normë konstante periodike interesi për pjesën e mbetur të detyrimit për secilën periudhë.

Pagesat e lidhura me qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët njihen në bazë lineare si një shpenzim në fitim ose humbje. Qira afatshkurtra janë qira me afat qiraje prej 12 muajsh ose më pak.

Asetet me vlerë të ulët janë asetet me një vlerë prej 5,000 Euro ose më pak. *Përcaktimi i afatit të qirasë së kontratave me opsionet e rinovimit dhe përfundimit* Shoqëria përcakton afatin e qirasë si termin e pa-anulueshëm të qirasë, së bashku me çdo periudhë të mbuluar nga një opsion për të zgjatur qiranë nëse ka baza të sigurta për t'u ushtruar, ose ndonjë periudhë e mbuluar nga një opsion për të përfunduar qiranë, nëse ka baza të arsyeshme që të mos ushtrohet.

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)

#### 3.4. Qiratë (vazhdim)

Në lidhje me kontratën e qirasë për zyrat, qiradhënësi ka të drejtë të njoftojë qiramarrësin jo më vonë se 1 vit para skadimit të afatit të qirasë. Rinovimi do të jetë për të paktën 5 vjet, në varësi të kushteve dhe kushteve të njëjta të përcaktuara në marrëveshjen ekzistuese.

Shoqëria ka disa kontrata qiraje që përfshijnë mundësi zgjatjeje dhe përfundimi. Shoqëria zbaton gjykimin në vlerësimin nëse ka baza të sigurta nëse do të ushtrojë opsionin për rinovimin ose përfundimin e qirasë. Kjo do të thotë, se shqyrton të gjithë faktorët relevantë që krijojnë një nxitje ekonomike për të që të ushtrojë rinovimin ose përfundimin e kontratës. Pas datës së fillimit, Shoqëria rivlerëson afatin e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim të rrethanave që është brenda kontrollit të saj dhe ndikon në aftësinë e saj për të ushtruar ose jo për të ushtruar mundësinë e rinovimit ose të ndërprerjes.

#### 3.5. Aktivet afatgjata jo të trupëzuara

Aktivitet afatgjata jomateriale paraqesin tarifën që shoqëria ka paguar në ZVRPP dhe tarifën për licensimin në OST dhe ERE.

Normat e amortizimit dhe metodat e përdorura për kategoritë e aktiveve afatgjata jomateriale, paraqiten si më poshtë:

Aktivitet afatgjata jomateriale	Mbi koston historike	15%
---------------------------------	----------------------	-----

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohet në fund të çdo periudhe raportuese.

#### 3.6. Instrumentat financiarë

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një detyrim financiar ose instrument të kapitalit neto të një njësie tjetër.

**Instrumentet financiare - njohja fillestare.** Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për koston e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

**Aktivitet financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - kategoritë e matjes.** Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA (sipas paragrafit më lart). Klasifikimi dhe matja e mëpasme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit monetar të aktivitetit.

**Aktivitet financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - modeli i biznesit.** Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi Shoqëria menaxhon aktivet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i Shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale (“mbajtja për mbledhje e flukseve monetare”) ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve (“mbajtja për mbledhje e flukseve monetare dhe shitje”) ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit të biznesit “të tjera” dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare individuale (në nivel individual) bazuar në të gjithë evidencën përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)

#### 3.6. Instrumentat financiare (vazhdim)

individual në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohen menaxherët. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në përcaktimin e modeleve të biznesit për aktivet e saj financiare.

**Aktivet financiare - klasifikimi dhe matja e mëpasshme - karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare.** Kur modeli i biznesit ka si objekt mbajtjen e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm

shumën për riskun e kredisë, vlerën kohore të parasë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj riskut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, aktivi financiar klasifikohet dhe matet me VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 4 për gjykimet kritike të aplikuara nga Shoqëria në kryerjen e testit VPPI për aktivet e saj financiare.

**Aktivet financiare - fshirja.** Aktivet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur Shoqëria ka kryer çdo përpjekje për rimarrjen dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrjen. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit. Treguesit që nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rimarrjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mosshlyerjes, paafësi paguese dhe falimentim. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që janë subjekt i zbatimit me forcë të marrëveshjes kur Shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të arkëtueshme sipas termave kontraktuale, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për marrjen e tyre.

**Aktivet financiare - çregjistrimi.** Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

**Detyrimet financiare - kategoritë e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në KA, përveç (i) detyrimeve financiare të matura me VDNFH: ky klasifikim aplikohet për derivativet, detyrimet financiare të mbajtura për shitje (p.sh. pozicionet afatshkurtra me letra me vlerë), shuma e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

**Detyrimet financiare - çregjistrimi.** Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

**Netimi i instrumenteve financiare.** Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)

#### 3.6. Instrumentat financiare (vazhdim)

për netimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë netimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagese dhe (iii) në rast të paaftësisë paguese ose falimentimit.

##### *Instrumente financiare jo-derivative*

Shoqëria disponon dhe instrumente financiare jo-derivative, të përbëra vetëm nga parapagime dhe të arkëtueshme të tjera, mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë, llogari të pagueshme, të tjera detyrime dhe detyrime ndaj ortakëve. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë duke shtuar, për instrumentet e mbajtur jo me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit/humbjes, çdo kosto transaksioni që lidhet drejtpërsëdrejti me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare jo-derivative maten siç përshkruhet me poshtë:

##### *a) Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë*

Mjetet monetare dhe të tjerë ekuivalentë përfshijnë arkën, depozitat dhe llogaritë rrjedhëse bankare si dhe investimet afatshkurta me likuiditet të lartë dhe me maturitet tre muaj ose më pak. Ato njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe maten më pas me koston e amortizuar

##### *b) Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionet për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogariten kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet në përputhje me termat kontraktuale të këtyre llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi financiar, dhe mospagesa apo vonesa në pagesa konsiderohen tregues për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *c) Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera*

Llogaritë e pagueshme dhe detyrime të tjera paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston të amortizuar.

#### 3.7. Zhvlerësimi

Aktivet me jetëgjatësi të papërcaktuar nuk janë subjekt i amortizimit dhe testohen çdo vit për zhvlerësime të mundshme.

Një aktiv testohet për zhvlerësim nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme të parashikuara të aktivitetit.

Një humbje zhvlerësimi në lidhje me aktivin llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës së rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është vlera e drejtë minus kostot për shitje ose vlera në përdorim e një aktivi, cilado qoftë më e lartë.

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit aktivet grupohen në grupet më të vogla të mundshme për të cilat flukset monetare identifikohen veçmas (njësi gjeneruese të parasë).

## **KARAVASTA SOLAR SHPK**

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)*

---

### **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)**

#### **3.8. Inventari**

Inventari paraqitet me vlerën më të vogël mes kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto përbëhet nga kostot e materialeve direkte, punës direkte, kosto të tjera direkte dhe shpenzime të lidhura me prodhimin. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e vlerësuara të përfundimit dhe kostot e vlerësuara të nevojshme për të bërë shitjen.

#### **3.9. Kapitali**

Kapitali është njohur në pasqyrat financiare me vlerën nominale.

#### **3.10 Tatimi-fitimi dhe tatimi i shtyrë**

Shpenzimi i tatim-fitimit përfshin tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatim-fitimi njihet drejtpërdrejt në fitime ose humbje përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen drejtpërdrejt në kapital ose në të ardhura gjithëpërfshirëse.

Tatim-fitimi i periudhës llogaritet sipas normave tatimore të miratuara në datën e raportimit dhe duke marrë në konsideratë çdo rregullim të tatimit të pagueshëm nga vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë llogaritet mbi diferencat e përkohshme midis vlerës së mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat e tatimit që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme në periudhën kur ato rimerren, bazuar në legjislacionin në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet deri në atë masë ku mund të pritet që në të ardhmen të ketë fitime të tatueshme të mjaftueshme për realizimin e diferencave të përkohshme.

Aktivet nga tatimet e shtyra rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në rastet kur nuk është më e mundur që përfitimi tatimor përkatës të realizohet.

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe atij të shtyrë Shoqëria merr në konsideratë ndikimin e një pozicioni tatimor të paqartë dhe gjithashtu mundësinë e rritjes së detyrimit tatimor dhe interesave.

Shoqëria beson se njohja e detyrimeve fiskale është e përshtatshme për vitet në vazhdim pasi është bazuar në vlerësimin e një sërë faktorësh, përfshirë interpretimin e ligjit tatimor si dhe eksperiencat e mëparshme.

Ky vlerësim mbështetet në një sërë vlerësimesh dhe supozimesh që përfshijnë gjykime lidhur me ngjarje të ardhshme. Informacione të reja mund të shkaktojnë ndryshime në gjykimin e Shoqërisë lidhur me përshtatshmërinë e detyrimeve ekzistuese tatimore; të tilla ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore të periudhës në të cilën ndodhin.

#### **3.11. Përfitimet e punonjësve**

*Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*

Bazuar në legjislacionin shqiptar, Shoqëria është e detyruar të paguajë në emër të punonjësve të saj kontribute të detyrueshme në një fond të veçantë të menaxhuar nga qeveria. Të gjitha pagesat dhe detyrimet njihen si shpenzime në periudhën të cilës ato i përkasin.

#### **3.12. Provizionet**

Provizionet për restaurime mjedisesh, kostot e ristrukturimit, detyrimet tatimore dhe pretendimet legale njihen nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, për të cilin do të kërkohen flukse dalëse parash për

**3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)****3.12. Provizionet (vazhdim)**

shlyerjen e tij, dhe që shuma e këtyre flukseve llogaritet në mënyrë të besueshme. Nuk njihen provizione për humbje të ardhshme operative.

Kur ka një numër të madh detyrimesh të njëjta, probabiliteti që një fluks dalës të kërkohej për t'i shlyer përcaktohet duke e konsideruar klasën e detyrimeve si një të vetme. Një provizion njihet edhe kur ka të ngjarë që fluksi dalës për ndonjë nga zërat e së njëjtës klasë detyrimesh të jetë i vogël.

Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet specifike të detyrimit. Rritja e provizionit për shkak të kalimit të kohës njihet si shpenzim interesi. Provizionet rishikohen në fund të çdo periudhe raportuese dhe përshtaten për të reflektuar vlerësimin më të mirë aktual. Nëse përcaktohet se nuk do kërkohej me burime ekonomike për të shlyer detyrimin, provizioni rimerret. Shuma e rimarrë njihet në fitim ose humbje.

**3.13. Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat janë flukset hyrëse bruto të përfitimeve ekonomike lindur në rrjedhën normale të aktiviteteve të njësisë ekonomike që rezultojnë në rritje të kapitalit neto gjatë periudhës dhe nuk përfshijnë rritjet e kapitalit neto në sajë të kontributeve të ortakëve. Të ardhurat përfshijnë vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar apo të arkëtueshme nga shitja e të mirave dhe shërbimeve në rrjedhën normale të aktiviteteve të Shoqërisë. Të ardhurat nuk përfshijnë tatimin e vlerës së shtuar, kthimet, rabatet dhe zbritjet si dhe shitjet e eliminueshme brenda Shoqërisë, nëse ka.

*(a) Të ardhurat nga interesat*

Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kur një aktiv zhvlerësohet, Shoqëria redukton vlerën e mbartur të tij deri në vlerën e rikuperueshme, e cila është e barabartë me flukset e ardhshme të aktualizuara me normën efektive të interesit të instrumentit, dhe vazhdon të njohë shumën e skontuar si të ardhur nga interesi. Të ardhurat nga interesi në lidhje me huatë e zhvlerësuara njihen duke përdorur normën fillestare efektive të interesit.

*(b) Të ardhura të tjera*

Të ardhurat e tjera të Shoqërisë përbëhen nga të ardhurat nga aktiviteti saj i zakonshëm (fitimet nga shitjet e aktiveve, të ardhurat nga qiratë operationale, kompensimet e marra për shpenzimet e bëra), të cilat njihen në periudhën të cilës ato i përkasin.

**3.14. Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara**

Standardet e ndryshuara në vijim hyjnë në fuqi më 1 janar 2023, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material tek Shoqëria:

- SNRF 17 "Kontratat e sigurimit" (lëshuar më 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023). Ndryshimet në SNRF 17 dhe një ndryshim në SNRF 4 (publikuar më 25 qershor 2020 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).
- Opsioni i tranzicionit për siguresit që zbatojnë SNRF 17 – Ndryshimet në SNRF 17 (publikuar më 9 dhjetor 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).
- Ndryshime në SNK 1 dhe Deklarata e praktikës SNRF 2: Dhënia e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël (publikuar më 12 shkurt 2021 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023).

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (vazhdim)

#### 3.14. Zbatimi i Standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

- Ndryshime në SNK 8: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (botuar më 12 shkurt 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023).
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm – Ndryshimet në SNK 12 (publikuar më 7 maj 2021 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023)
- Ndryshime në SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Reforma Ndërkombëtare Tatimore – Rregullat Model Shtylla e Dytë (botuar më 23 maj 2023).

#### 3.15. Standarde dhe interpretime të reja, ende të paadoptuara

Një numër i standardeve të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Shoqëria planifikon të zbatojë këto ndryshime kur të hyjnë në fuqi.

- Ndryshimet në SNRF 16 Qiratë: Detyrimi i Qirasë në një shitje dhe kthim me qira (leaseback) (lëshuar më 22 shtator 2022 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).
- Klasifikimi i detyrimeve si rrjedhëse ose afatgjata – Ndryshime në SNK 1 (fillimisht i publikuar më 23 janar 2020 dhe i ndryshuar më pas më 15 korrik 2020 dhe 31 tetor 2022, përfundimisht në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2024).
- Ndryshime në SNK 7 Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese: Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Lëshuar më 25 maj 2023).
- SNRF 14, Llogaritë e Shtyra Rregullatore (lëshuar më 30 janar 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).
- Shitja ose kontributi i aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët – Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK).

### 4. VLERËSIMET DHE GJYKIMET NË ZBATIMIN E POLITIKAVE KONTABËL

Në datë 1 Janar 2023 Shoqëria ka ndryshuar monedhën funksionale të saj nga Lekë në Euro bazuar në analizën e kushteve ekonomike, manaxhimit të riskut dhe flukset hyrëse dhe dalëse të mjeteve monetare. Na kjo datë monedha funksionale e Shoqërisë është Euro, e cila është e ndryshme nga monedha e mjedisit kryesor ekonomik në të cilin Shoqëria kryen veprimtarinë e saj. Përcaktimi se cilat janë kushtet specifike themelore ekonomike, kërkon gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, Shoqëria vlerëson midis faktorëve të tjerë, burimet e të ardhurave si dhe rreziqet që lidhen me aktivitetet. Shumica e operacioneve të Shoqërisë janë të matura në Euro dhe gjithashtu, Euro është monedha në të cilën menaxhohen rreziqet dhe ekspozimet e Shoqërisë si dhe matet performanca e biznesit të saj.

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

#### 5.1. Faktorët e riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj disa risqeve si: risku i tregut (përfshirë riskun e kurseve të këmbimit dhe riskun e normës së interesit), risku i kredisë dhe risku i likuiditetit. Programi i Shoqërisë për menaxhimin e përgjithshëm të riskut fokusohet në përcaktimin e kufijve të ekspozimit ndaj risqeve të ndryshme.

##### a) Risku i tregut

Risku i tregut është risku i humbjes që rezulton nga ndryshimet në çmimet e tregut, kurset e këmbimit dhe normat e interesit. Niveli i riskut të tregut ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar ndryshon në varësi të kushteve të tregut, pritshmërive të ndryshimeve të ardhshme të çmimeve ose normave të tregut dhe përbërjes së aktiveve fizike dhe portofolit të kontratave të Shoqërisë.

##### i. Risku i kurseve të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit kryesisht në lidhje me ekspozimet në monedhën Euro. Risku i kursit të këmbimit vjen kryesisht kur transaksionet e ardhshme tregtare ose aktivet dhe detyrimet janë të shprehura në një monedhë të ndryshme nga monedha funksionale e Shoqërisë.

Shoqëria nuk mbrohet ndaj ekspozimit kundrejt riskut të kursit të këmbimit pasi nuk priten humbje të rëndësishme për shkak të ndryshueshmërisë në kurset e këmbimit krahasuar me kurset që mbizotërojnë në datën e raportimit.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj riskut të kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2023 është si më poshtë:

2023	EURO	LEKË	Totali
Mjete monetare dhe ekuivalente	135,821,268	16,181,701	152,002,969
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	300,930,347	1,709,219,676	2,010,150,023
Instrument financiar	399,036,425	-	399,036,425
	<b>835,788,040</b>	<b>1,725,401,377</b>	<b>2,561,189,417</b>
Llogari të pagueshme dhe të tjera detyrime	7,621,401,550	264,198	7,621,665,748
Detyrime qira financiare	-	-	-
Hua të pagueshme	3,953,340,855	-	3,953,340,855
Interesa të pagueshëm	181,884,327	-	181,884,327
Tatim fitimi i pagueshëm	-	22,824,353	22,824,353
Instrument financiare derivative	465,292,232	-	465,292,232
	<b>12,221,918,964</b>	<b>23,088,551</b>	<b>12,245,007,515</b>
<b>Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2023</b>	<b>(11,386,130,924)</b>	<b>1,702,312,826</b>	<b>(9,683,818,098)</b>

**KARAVASTA SOLAR SHPK**

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

**5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (vazhdim)****5.1. Faktorët e riskut financiar (vazhdim)****a) Risku i tregut (Vazhdim)**

<b>2022</b>	<b>EURO</b>	<b>LEKË</b>	<b>Totali</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente	54,842,051	2,342,867	57,184,918
Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera	556,758,911	360,132,014	916,890,925
Instrument financiar	237,193,455	-	237,193,455
	<b>848,794,417</b>	<b>362,474,881</b>	<b>1,211,269,298</b>
<b>a) Llogari të pagueshme Risku i tregut</b>	2,114,390,251	146,221	2,114,536,472
dhe të tjera detyrime			
Detyrime qira financiare	-	1,762,864	1,762,864
Hua të pagueshme	439,785,500	-	439,785,500
Interesa të pagueshëm	6,488,781	-	6,488,781
	<b>2,560,664,532</b>	<b>1,909,085</b>	<b>2,562,573,617</b>
<b>Rreziku i monedhës më 31 dhjetor 2022</b>	<b>(1,711,870,115)</b>	<b>360,565,796</b>	<b>(1,351,304,319)</b>

Më poshtë paraqiten kurset e rëndësishme të këmbimit në Lekë për njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Lekë/EUR	103.88	114.23

Gjatë vitit kurset mesatare të këmbimit në Lekë për njësi të monedhës së huaj kanë qenë si më poshtë:

	<b>2023</b>	<b>2022</b>
Lekë/EUR	108.75	118.92

**Analiza e ndjeshmërisë ndaj kurseve të këmbimi**

	<b>31 dhjetor 2023</b>
ALL mbivlerësohet me 10%	(170,231,283)
ALL zhvlerësohet me 10%	170,231,283

**i. Risku i normës së interesit**

Të gjitha aktivet me interes të Shoqërisë kanë të bëjnë me llogaritë bankare. Të ardhurat dhe flukset monetare të Shoqërisë nuk janë të ekspozuara në mënyrë të ndjeshme ndaj ndryshimeve në normat e interesit në treg. Shoqëria ka detyrime që mbartin interesa dhe shoqëria ka blerë një instrument financiar për mbrojtjen ndaj ndryshimit të normës së interesit.

**KARAVASTA SOLAR SHPK**

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (vazhdim)****5.1. Faktorët e riskut financiar (vazhdim)****b) Risku i kredisë**

Risku i kredisë është risku i humbjes financiare të shkaktuar nga dështimi i palës tjetër për të shlyer detyrimet e saj financiare kundrejt Shoqërisë dhe vjen kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

*Llogaritë e arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë përbëhen nga kërkesat për t'u arkëtuar nga klientët e saj. Vlera e mbetur e aktiveve financiare përfaqëson riskun maksimal të kreditit. Risku maksimal i kreditit në datën e raportimit është:

	<b>31 dhjetor 2023</b>	<b>31 dhjetor 2022</b>
Mjete monetare dhe të tjerë ekuivalentë	152,002,969	57,184,918
Llogari të arkëtueshme	2,010,150,023	916,890,925
<b>Totali</b>	<b>2,162,152,992</b>	<b>974,075,843</b>

Risku i likuiditetit përkufizohet si risku që njësia të hasë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve të veta financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kërkesave ditore për përdorim të burimeve të veta të parasë, kryesisht për të shlyer shpenzimet operative për aktivitetin e saj të zakonshëm. Menaxhimi monitoron çdo ditë, javë dhe muaj duke përditësuar parashikimet e flukseve të parasë së Shoqërisë.

Tabela më poshtë analizon detyrimet financiare të Shoqërisë sipas niveleve të maturimit bazuar në periudhën e mbetur të raportimit deri në datën kontraktuale të maturimit:

**c) Risku i likuiditetit**

<b>2023</b>	<b>Deri në 6 muaj</b>	<b>6 deri 12 muaj</b>	<b>1 deri 5 vjet</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivët financiarë</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalente	152,002,968	-	-	152,002,968
Llogari të arkëtueshme	135,700,152	1,696,679,811	177,770,061	2,010,150,024
Instrument financiar	-	-	399,036,425	399,036,425
	<b>287,703,120</b>	<b>1,696,679,811</b>	<b>576,806,486</b>	<b>2,561,189,417</b>
Llogari të pagueshme dhe të tjera detyrime	264,198	7,621,401,550	-	7,621,665,748
Detyrime qira financiare	-	-	-	-
Hua të pagueshme	-	-	3,953,340,855	3,953,340,855
Interesa të pagueshëm	-	-	181,884,327	181,884,327
Tatim fitimi i pagueshëm	22,824,353	-	-	22,824,353
Instrument financiar derivative	-	-	465,292,232	465,292,232
	<b>23,088,551</b>	<b>7,621,401,550</b>	<b>4,600,517,414</b>	<b>12,245,007,515</b>
<b>Totali i riskut të likuiditetit më 31 dhjetor 2023</b>	<b>264,614,569</b>	<b>(5,924,721,739)</b>	<b>(4,023,710,928)</b>	<b>(9,683,818,098)</b>

**KARAVASTA SOLAR SHPK**

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***5. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (vazhdim)****5.1. Faktorët e riskut financiar (vazhdim)****c) Risku i likuiditetit**

<b>2022</b>	<b>Deri në 6 muaj</b>	<b>6 deri 12 muaj</b>	<b>1 deri 5 vjet</b>	<b>Totali</b>
<b>Aktivitet financiar</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalente	57,184,918	-	-	57,184,918
Llogari të arkëtueshme	8,307,633	908,583,292	-	916,890,925
Instrument financiar	-	-	237,193,455	237,193,455
	<b>65,492,551</b>	<b>908,583,292</b>	<b>237,193,455</b>	<b>1,211,269,298</b>
Llogari të pagueshme dhe të tjera detyrime	121,428	2,114,415,044	-	2,114,536,472
Detyrime qira financiare	-	1,030,692	732,172	1,762,864
Hua të pagueshme	-	-	439,785,500	439,785,500
Interesa të pagueshëm	-	-	6,488,781	6,488,781
	<b>121,428</b>	<b>2,115,445,736</b>	<b>447,006,453</b>	<b>2,562,573,617</b>
<b>Totali i riskut të likuiditetit më 31 dhjetor 2022</b>	<b>65,371,123</b>	<b>(1,206,862,444)</b>	<b>(209,812,998)</b>	<b>(1,351,304,319)</b>

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 6. VLERA E DREJTË

Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas niveleve në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë: (i) niveli 1 janë matje me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktive ose pasive identike, (ii) matjet e nivelit 2 janë teknika vlerësimi me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose detyrimin, qoftë drejtpërdrejt (d.m.th., si çmime) ose indirekt (d.m.th., të nxjerra nga çmimet) dhe (iii) matjet e nivelit 3 janë vlerësime që nuk bazohen në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (d.m.th., inpute të pavëzhgueshme). Për Shoqërinë hierarkia në të cilën kategorizohen matjet e vlerës së drejtë janë si më poshtë:

	2023		2022	
	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 2	Niveli 3
<b>AKTIVE FINANCIARE</b>				
Instrument financiar	399,036,425	-	237,193,455	-
Mjete monetare dhe ekuivalente	-	152,002,968	-	57,184,918
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	556,758,911
<b>VLERA E DREJTË MË 31 DHJETOR</b>	<b>399,036,425</b>	<b>152,002,968</b>	<b>237,193,455</b>	<b>613,943,829</b>
<b>DETYRIME FINANCIARE</b>				
Llogari të pagueshme	-	7,621,401,550	-	1,940,869,460
Hua të pagueshme	-	3,953,340,855	-	439,785,501
Interesa të pagueshëm	-	181,884,327	-	6,488,781
Instrument financiar	-	465,292,232	-	-
<b>VLERA E DREJTË MË 31 DHJETOR</b>	<b>-</b>	<b>12,221,918,964</b>	<b>-</b>	<b>2,387,143,742</b>

Nuk ka pasur ndryshime në teknikën e vlerësimit për matjet e përsëritura të vlerës së drejtë të nivelit 3 gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2023.

### 7. Aktivet afatgjata në proces

Kosto	Aktivët afatgjata në proces
Më 31 dhjetor 2022	<b>1,345,764,695</b>
Shtesa	9,373,036,645
Materiale dhe pjesë panele në tranzit	4,895,213
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>10,723,696,553</b>

Shoqëria gjatë vitit 2023 ka kapitalizuar punimet dhe shërbimet të cilat lidhen direkt me ndërtimin e impiantit fotovoltaik. Procesi i ndërtimit pritet të finalizohet në fillim të vitit 2024.

**KARAVASTA SOLAR SHPK**

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***8. Aktive afatgjata jomateriale**

Gjatë vitit 2021, Shoqëria është pajisur me licensën e prodhimit të energjisë nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Gjithashtu, Shoqëria për të siguruar vijimësinë e punës, ka bërë ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) pagesat e tarifave të nevojshme dhe ka siguruar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier (ZVRPP Fier) dokumentacion.

Shoqëria ka kapitalizuar kosto që kanë të bëjnë me shpenzime zhvillimi që do të shpërndahen në periudhat e ardhshme.

Të gjitha sa më sipër janë paraqitur në pasqyrat financiare të Shoqërisë në zërin e Aktiveve Afatgjata Jomateriale si më poshtë:

<b>Kosto</b>	<b>Shpenzime zhvillimi të kapitalizuara</b>	<b>Aktive afatgjata jomateriale</b>	<b>Totali</b>
<b>Më 1 janar 2022</b>	<b>4,623,101</b>	<b>8,644,000</b>	<b>13,267,101</b>
Shtesa	16,520,125	506,000	17,026,125
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>21,143,226</b>	<b>9,150,000</b>	<b>30,293,226</b>
Shtesa	-	-	-
Efekt i këmbimit	(1,915,717)	(829,051)	(2,744,768)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>19,227,509</b>	<b>8,320,949</b>	<b>27,548,458</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>			
<b>Më 1 Janar 2022</b>	-	<b>(74,969)</b>	<b>(74,969)</b>
Shpenzimi i vitit	-	(1,341,200)	<b>(1,341,200)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2022</b>	-	<b>(1,416,169)</b>	<b>(1,416,169)</b>
Shpenzim i vitit	-	(1,372,500)	<b>(1,372,500)</b>
Efekt i këmbimit		252,672	<b>252,672</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	-	<b>(2,535,997)</b>	<b>(2,535,997)</b>
<b>Vlera e mbartur</b>			
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>21,143,226</b>	<b>7,733,831</b>	<b>28,877,057</b>
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>19,227,509</b>	<b>5,784,952</b>	<b>25,012,461</b>

**KARAVASTA SOLAR SHPK**

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

*(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)***9. Aktive me të drejtë përdorimi**

<b>Kosto</b>	<b>Aktive me të drejtë përdorimi</b>	<b>Totali</b>
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>2,089,306</b>	<b>2,089,306</b>
Shtesa	-	-
Pakesime	(2,036,708)	<b>(2,036,708)</b>
Efekt i Këmbimit	(52,598)	<b>(52,598)</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Amortizimi i akumuluar</b>		
Më 31 dhjetor 2022	<b>(348,218)</b>	<b>(348,218)</b>
Pakësime	1,131,706	<b>1,131,706</b>
Shpenzimi i vitit	(783,488)	<b>(783,488)</b>
Efekt i këmbimit	-	-
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2023</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Vlera e mbartur</b>		
<b>Më 31 dhjetor 2022</b>	<b>1,741,088</b>	<b>1,741,088</b>
<b>Më 31 dhjetor 2023</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Në muajin Shtator 2023 Shoqëria ka bërë mbylljen e kontratës për qiranë e tokës dhe si rrjedhojë ka bërë mbylljen e së drejtës të përdorimi, detyrimit të qirasë si dhe amortizimit të akumuluar.

**10. Instrument financiar derivativ – aset**

Instrumenti financiar (IRS – Bank Palatine) paraqet një instrument të cilin Shoqëria e ka blerë për mbrojtjen ndaj normës së interesit dhe i cili është shitur/ekzekutuar në korrik 2023 duke hequr të gjitha të drejtat dhe detyrimet që Shoqërisë i vinin nga kjo kontratë. Gjithashtu, Shoqëria ka nënshkruar edhe kontrata forward derivative (Forward Baseload 2 dhe Low Capture Price Solar) lidhur me cmimin e shitjes së energjisë elektrike. Këto instrumenta mbahen më vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe në dhjetor 2023 kemi një rivlerësim në rritje të tyre duke përfaqësuar një aset për Shoqërinë që gjeneron burime financiare.

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 10. Instrument financiar derivativ – aset (vazhdim)

Lidhur me kontratat për marrëveshjet e blerjes së energjisë (Purchase Power Agreements – PPA) Shoqëria ka kontratat derivative të iniciuara në datat si më poshtë:

1-Kontrata me datë nënshkrimi dhe tregtie 13 Korrik 2022 e cila ka si kohë efektive periudhën 1 Shkurt 2024 – 31 Dhjetor 2033. Sipas kësaj kontrate Karavasta do të arketoj flukset fikse bazuar në cmimin e dakordësuar prej 150 Eur/Mwh për periudhën e pare, 88 Eur/Mwh për periudhën e dytë, 66 Eur/Mwh për periudhën e tretë dhe 44 Eur/Mwh për periudhën e katërt, dhe do te paguajë flukset variabël të cilat bazohen në bursën Hungareze të tregtimit të Energjisë (HUPX).

2-Kontrata me datë nënshkrimi dhe tregtie 16 Nëntor 2023 e cila ka si kohë efektive periudhën 1 Janar 2024 – 31 Janar 2024. Sipas kësaj kontrate Karavasta do të arketoj flukset fikse bazuar në cmimin e dakordësuar prej 107 Eur/Mwh dhe do te paguajë flukset variabël të cilat bazohen në bursën Hungareze të tregtimit të Energjisë (HUPX).

3-Amendimin numër 1 me datë nënshkrimi dhe tregtie 14 Dhjetor 2023 e cila ka si kohë efektive periudhën 1 Shkurt 2025 – 30 Qershor 2025. Kjo është një amendimi i kontratës së përmendur në pikën 1 më sipër dhe ka si fokus rritjen e volumit të shitblerje të Garancive të Origjinës për vitin kalendarik 2025. Sipas kësaj kontrate Karavasta do të arketoj flukset fikse bazuar në cmimin e dakordësuar prej 81 Eur/Mwh dhe do te paguajë flukset variabël të cilat bazohen në bursën Hungareze të tregtimit të Energjisë (HUPX).

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet gjatë vitit të këtyre instrumentave financiar:

	IRS – Bank Palatine	Forward Baseload 2	Low Capture Price Solar
Vlera e drejtë më 01.01 2023	<b>237,193,455</b>	-	-
Rivlerësimi me vlerën e drejtë	(138,052,065)	23,731,178	375,305,247
Ekzekutimi i instrumentit financiar	(99,141,390)	-	-
<b>TOTALI</b>	<b>-</b>	<b>23,731,178</b>	<b>375,305,247</b>

### 11. Llogari të arkëtueshme tregtare dhe të tjera

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Parapagime furnitorëve	-	556,758,911
TVSH e zbritshme	1,696,679,811	351,824,381
Parapagime dhe kosto huaje	177,770,061	-
Klientë të arkëtueshëm	115,365,074	-
Të drejta të arkëtueshme në Doganë	12,539,866	8,007,633
Shpenzime të periudhave të ardhshme	7,795,212	-
Garanci të dhëna	-	300,000
<b>TOTALI</b>	<b>2,010,150,024</b>	<b>916,890,925</b>

### 12. Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Banka në Lekë	8,995,059	2,342,867
Banka në Euro	135,821,268	54,842,051
Escrow ne Lekë	7,186,642	-
<b>TOTALI</b>	<b>152,002,969</b>	<b>57,184,918</b>

Shoqëria ka disa llogari bankare në Lekë dhe në Euro pranë bankës Intesa San Paolo Bank Albania dhe Intesa San Paolo Bank Luxembourg.

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 13. Hua e pagueshme

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Huamarrje nga VMI-ALB-Karavasta B.V.	3,953,340,855	439,785,500
Interesa për t'u paguar	181,884,327	6,488,781
<b>TOTALI</b>	<b>4,135,225,182</b>	<b>446,274,281</b>

Shoqëria, më 29 korrik 2022, ka nënshkruar një marrëveshje kreditimi me kushte huaje. Vlera totale që Shoqëria mund të përdori është në shumën 38 milion Euro. Afati i pagesës së marrëveshjes së kreditimit është 31 tetor 2042. Interesi përlogaritet mbi vlerën e përdorur të kësaj marrëveshje. Norma e interesit është Euribor+ 7.1% dhe duke filluar nga data 1 korrik 2023 norma është fiksuar në nivelin 9%. Vlera e përdorur deri më 31 dhjetor 2023 është 38,056,804.52 Euro (2022: 3,850,000 Euro) dhe interesi i pagueshëm i llogaritur është 1,750,908.04 Euro (2022: 56,804.53 Euro). Kjo linjë kreditimi është përdorur për financimin e ndërtimit të implantit fotovoltaiik në lagunën e Karavastasë, Divjakë.

### 14. Detyrime qira financiare

Detyrimi i qirasë më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Detyrimi i qirasë afatshkurtër	-	1,030,692
Detyrimi i qirasë afatgjatë	-	732,172
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>1,762,864</b>

	2023	2022
<b>Balanca më 1 janar 2023</b>	<b>1,762,864</b>	-
Shtesa	-	2,089,306
Pakësime	(944,767)	-
Interesa	81,936	50,238
Pagesa	(847,435)	(376,680)
Diferenca – rivlerësim	(52,598)	-
<b>Balanca më 31 dhjetor 2023</b>	<b>-</b>	<b>1,762,864</b>

Në muajin Shtator 2023 Shoqëria ka bërë mbylljen e kontratës për qiranë e tokës dhe si rrjedhojë ka bërë mbylljen e së drejtës të përdorimi, detyrimit të qirasë si dhe amortizimit të akumuluar.

### 15. Llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve	3,341,232,254	1,328,976,827
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	4,280,169,297	611,892,633
Shpenzime të përlogaritura	-	173,545,584
Tatimi në burim	235,330	102,456
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	22,319	18,972
Të pagueshme të tjera	6,550	-
<b>TOTALI</b>	<b>7,621,665,750</b>	<b>2,114,536,472</b>

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 16. Instrument financiar derivativ - detyrim

Instrumenti financiar (IRS – Swap EBRD, IFC, ISP) paraqet një instrument të cilin Shoqëria e ka blerë për mbrojtjen ndaj normës së interesit. Gjithashtu, Shoqëria ka nënshkuara edhe kontratë forward derivative (Low Capture Price Solar 2025) lidhur me cmimin e shitjes së energjisë elektrike. Këto instrumenta mbahen më vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe në dhjetor 2023 kemi një rivlerësim në ulje të tyre duke përfaqësuar një detyrim për Shoqërinë.

Gjatë vitit 2023 nga rivlerësimi i instrumentit financiar IR-Swap, bazuar tek diferenca midis cmimit të plotë (full price) dhe cmimit të pastër (clean price) është bërë edhe riklasifikimi i një vlere prej 78,492 Euro nga të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në rezultatin e periudhës.

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet gjatë vitit të këtyre instrumentave financiar:

	IR - Swap EBRD, IFC, ISP	Low Capture Price Solar 2025
Vlera e drejtë më 01.01 2023	-	-
Shtesa	-	-
Rivlerësimi me vlerën e drejtë	412,180,258	53,111,974
<b>TOTALI</b>	<b>412,180,258</b>	<b>53,111,974</b>

### 17. Kapitali themeltar

Kapitali përbëhet nga 1 kuotë në vlerën 867,386,000 Lekë, të zotëruar nga shoqëria e huaj "VMI-ALB-Karavasta BV". Gjatë vitit 2023 kemi pasur një rritje të kapitalit nga Shoqëria në vlerën 855,000,000 Lekë.

### 18. Rezerva nga rivlerësimi

	Vlera e drejtë e instrumenteve financiarë
Vlera e drejtë më 01.01 2022	-
Rivlerësimi me vlerën e drejtë	22,441,055
Rivlerësimi me kursin këmbimit përealizuar	(5,282,800)
<b>Balanca e rezervës së rivlerësimit 31.12.2022</b>	<b>17,158,255</b>
Rivlerësimi me vlerën e drejtë - IRS Banque Palatine	(138,052,065)
Rivlerësimi me vlerën e drejtë - IRS (EBRD, IFC, ISP)	(412,180,258)
Rivlerësimi me vlerën e drejtë - Baseload Hungary Jan-24 (Axpo)	23,731,178
Rivlerësimi me vlerën e drejtë - Low Capture Price Solar (SHELL)	375,305,247
Rivlerësimi me vlerën e drejtë - Low Capture Price Solar (SHELL 2025)	(53,111,974)
Riklasifikim në rezultat (Cmimi i pastër Vs Cmimi i plotë)	(8,153,853)
Rimarrja rivlerësimi kursit të këmbimit të përealizuar	5,282,800
<b>Ndryshime në vlerën e drejtë (të ardhura gjithëpërfshirëse)</b>	<b>(207,178,925)</b>
<b>Balanca e rezervës së rivlerësimit 31.12.2023</b>	<b>(190,020,670)</b>

Gjatë vitit 2023 janë paraqitur lëvizjet në vlerën e drejtë për të gjitha instrumentet financiare të cilat Shoqëria zotëron (ato që përfaqësojnë të drejta dhe ato që përfaqësojnë detyrime). Lëvizjet në vlerën e drejtë për këto instrumenta paraqiten në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në vlerën (207,179,925) Lekë, ndërsa vlera prej (190,020,670) Lekë (2022: 17,158,255 Lekë) paraqet balancën në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë të akumuluar deri në datën 31 dhjetor 2023.

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 19. Të ardhura të veprimtarisë

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Të ardhura nga shitja e energjisë	2,970,990	-
Të ardhura nga kontrata hedge	446,479,499	-
<b>TOTALI</b>	<b>449,450,489</b>	<b>-</b>

Në muajin dhjetor 2023 Shoqëria ka fiskalizuar faturën e parë për shitjen e energjisë elektrike ndaj Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) e cila lidhej me faturimin e Kwh të gjeneruara gjatë fazës së testimit të parkut voltaik. Gjithashtu, gjatë vitit 2023 janë njohur edhe të ardhurat që lidhen me kontratën derivative të mbrojtjes për cmimin dhe Mwh e energjisë elektrike gjatë muajve tetor – dhjetor.

### 20. Shpenzime personeli

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzime të sigurimeve shoqërore	257,796	215,388
<b>TOTALI</b>	<b>257,796</b>	<b>215,388</b>

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2023 janë 257,796 Lekë (2022: 215,388 Lekë) dhe përbëhen nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të paguara për administratorët e Shoqërisë.

### 21. Shpenzime operative

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Shpenzime konsulence	1,221,346	789,567
Shpenzime testimi dhe iniciimi	14,581,725	-
Shpenzime audit	823,366	-
Shpenzime për blerje energjie	334,819	-
Shpenzime ligjore dhe noteriale	104,400	-
Shpenzime për tarife transmetimi	25,994	-
Komisione bankare	-	271,039
Taksa dhe tarifa vendore	633,330	121,980
Gjoha dhe penalitete	430,808	40,982
Shpenzime të tjera	10,517,067	4,000
<b>TOTALI</b>	<b>28,672,855</b>	<b>1,227,568</b>

Shpenzimet e testimit dhe iniciimit të njohura gjatë vitit 2023 lidhen me fazën testuese në parkun voltaik për fillimin e prodhimit të energjisë elektrike. Shpenzimet për blerjen e energjisë elektrike dhe tarifa e transmetimit lidhet me blerjet që janë bërë nga KESH me qëllim fillimin e prodhimit.

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 22. Të ardhura financiare, neto

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Fitime nga këmbimet valutore	337,569,404	(50,925)
Humbje nga këmbimet valutore	(283,706,892)	-
Riklasifikim vlerë e drejtë (FV) hedge	8,153,853	-
Shpenzime interesi	-	(11)
Fitimi nga mbyllja e kontratës së qirasë sipas SNRF 16	21,681	-
<b>TOTALI</b>	<b>62,038,046</b>	<b>(50,936)</b>

Gjatë vitit 2023 nga rivlerësimi i instrumentit financiar IR-Swap, bazuar tek diferenca midis cmimit të plotë (full price) dhe cmimit të pastër (clean price) është bërë edhe riklasifikimi i një vlere prej 78,492 Euro nga të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në rezultatin e periudhës, paraqitur në zërin "Riklasifikim vlerë e drejtë (FV) hedge".

### 23. Tatimi fitimi i pagueshëm

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Tatim fitimi për vitin	(72,824,353)	-
Tatim fitimi i parapaguar	50,000,000	-
<b>TOTALI</b>	<b>(22,824,353)</b>	<b>-</b>

Gjatë vitit 2023 Shoqëria ka paguar kështet e tatim fitimit për periudhën tetor – dhjetor në vlerën 50,000,000 Lekë. Bazuar në legjislacionin fiskal, personat juridike që kryejnë investime me vlerë mbi 1 miliardë Lekë, kanë të drejtë të mbartin humbjet tatimore për një periudhë deri në 5 vjet. Duke qenë se vlera e përgjithshme e investimit kalon 1 miliardë Lekë, Shoqëria plotëson kushtin e lartëpërmendur dhe si rrjedhojë ka të drejtën të mbartë humbjen fiskale deri në 5 vjet. Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e aplikueshme e tatim-fitimit për vitin 2023 është 15% (2022: 15%).

	31 dhjetor 2023	%
Fitimi/(humbja) vitit para tatimit	481,185,383	
Tatim-fitimi i llogaritur me normën e aplikueshme	(72,177,807)	15.00%
<i>Rregullime:</i>		
Shpenzime të panjohura	(1,216,570)	
Humbje mbartur	570,024	
<b>Tatim-fitimi</b>	<b>(72,824,353)</b>	

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 Shoqëria ka rezultuar me fitim fiskal prej 485,495,688 Lekë, për të cilin tatim-fitimi i llogaritur është 72,824,353 Lekë. Shoqëria kishte humbje tatimore të mbartura, të cilat janë përdorur gjatë vitit 2023.

## KARAVASTA SOLAR SHPK

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023

(shumat në Lekë, nëse nuk është specifikuar ndryshe)

### 24. Palët e lidhura

Voltalia S.A zotëron indirekt 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Veprimet dhe tepricat me Voltalia S.A dhe filialet e saj, të cilat konsiderohen palë të lidhura, shfaqen në këtë shënim. Drejtimi Ekzekutiv i Shoqërisë konsiderohet gjithashtu palë e lidhur.

#### Transaksionet me palët e lidhura

	2023	2022
<b>Te pagueshme me VMI-ALB-KARAVASTA B.V</b>		
Huamarrje nga VMI-ALB-KARAVASTA B.V	3,953,340,854	439,785,500
Interesa të pagueshëm ndaj VMI-ALB-KARAVASTA B.V	181,884,327	6,488,781
	<b>4,135,225,181</b>	<b>446,274,281</b>
<b>Të pagueshme ndaj paleve te lidhura te tjera</b>		
Voltalia SA	4,280,169,297	611,892,633
Voltalia Albania Shpk	3,330,103,416	1,328,820,441
<b>Total</b>	<b>7,610,272,713</b>	<b>1,940,713,074</b>

Vlera e huasë dhe interesit ndaj VMI-ALB-Karavasta B.V paraqitur më sipër tregon balancën totale në fund të vitit 2023. Lidhur me lëvizjet për interesin e njohur gjatë 2023 vlera është 1,750,908 Euro (181,884,327 Lekë), ndërsa pjesa e shtuar e huasë është në vlerën 34,206,805 Euro (3,553,402,855 Lekë). Vlerat në Euro paraqiten të rivlerësuara me kursin në fund të vitit.

### 25. Ngjarje pas periudhës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera përveç sa më sipër, mbas datës së raportimit të cilat mund të kërkojnë rregullime apo paraqitje të informacionit në pasqyrat financiare të Shoqërisë.